



## **Informacione të dobishme në lidhje me aplikimin për akses të lirë në tregun e punës në Republikën e Serbisë**

Shërbimi Kombëtar i Punësimit, si shërbimi publik i punësimit i Republikës së Serbisë, kryen veprimtari punësimi dhe ofron shërbime për punëkërkuessit dhe punëdhënësit. Nëse zgjidhni opsionin ndihmë për punësim nga Shërbimi Publik i Punësimit i Republikës së Serbisë, duke u regjistruar në faqen e web-it të Shërbimit Kombëtar të Punësimit <https://www.nsz.gov.rs/employee> ju do të keni opsionet e mëposhtme:

- regjistrim të personalizuar në gjuhën tuaj amtare;
- të merrni informacion për një numër të madh të vendeve të lira të punës në të gjithë territorin e Republikës së Serbisë;
- të dalloheni dhe të kontaktoheni nga një numër i madh punëdhënësish;
- të kryeni kërkime të detajuara të vendeve vakante, sipas të gjitha kriterëve përkatëse;
- të merrni informacion për vendet e lira të punës të shpallura nga punëdhënësit në degët e Shërbimit Kombëtar;
- të merrni këshilla të dobishme për objektin e kërkimit të punës dhe paraqitjen tek punëdhënësi (shkrimi i një rezymeje pune dhe kryerja e intervistës me punëdhënësin);
- të merrni informacion rreth të gjitha aktiviteteve në Shërbimin Kombëtar;
- të merrni tregues statistikorë për ofertën dhe kërkesën në tregun e punës në Republikën e Serbisë;
- të merrni akses në bazën e të dhënave të rregulloreve ligjore aktuale që lidhen me tregun e punës.

Të dhënat tuaja personale do mbrohen plotësisht nga keqpërdorimi i të dhënave.

Të gjitha shërbimet e Shërbimit Kombëtar të Punësimit janë pa pagesë.

Për të gjitha informacionet shtesë dhe mbështetjen në kërkimin e një pune, mund të kontaktoni Shërbimin Kombëtar të Punësimit me e-mail: [openbalkan@nsz.gov.rs](mailto:openbalkan@nsz.gov.rs).